

## DOKUMENTET E PRANIMIT NË PROGRAMET E DOKTORATËS

---

Aplikimi për regjistrim në programet e doktoratës bëhet pranë Zyrës Informacionit dhe Dokumentacionit. Dosja individuale e aplikimit duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesa e kandidatit drejtuar Këshillit të Profesorëve;
- b. Formulari i aplikimit (shkarkohet online);
- c. CV personale shoqëruar me bibliografinë e punimeve shkencore, të cilat duhet të jenë të dokumentuara, nëse kandidati ka të tilla;
- d. Fisha e doktorantit (shkarkohet online);
- e. Kopje të noterizuar të diplomës Master i Shkencave ose Master i Arteve të Bukura, apo të një diplome tjetër studimi ekuivalente me to, të shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës. Diploma e huaj shoqërohet me vërtetimin e njohjes nga MAS. Preferohet që diploma me të cilën kandidati pranohet në program të jetë në fushë të njëjtë, të ngjashme ose të përafërt studimi;
- f. Kopje të noterizuar të diplomave apo certifikatave të kualifikimeve të ciklit të tretë apo të një diplome ose certifikate ekuivalente me to, shoqëruar me listën e notave apo suplementin e diplomës, nëse kandidati disponon një të tillë;
- g. Vërtetim për vazhdimin e programeve të studimit të specializimit, së bashku me listën e notave të fituara deri në atë moment, nëse kandidati është duke ndjekur një program të tillë;
- h. Fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- i. Dy rekomandime nga persona me titull akademik, të cilët njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- j. Një deklaratë që pranon të shlyejë të gjitha detyrimet financiare lidhur me koston e këtyre studimeve, sipas përcaktimeve të bëra nga vetë institucioni;
- k. Dëshmi të gjuhës/gjuhëve të huaja, sipas legjislacionit në fuqi;
- l. Vërtetim nga qendra e punës, nëse është i punësuar;
- m. Mandat për tarifën e aplikimit për konkurrim;
- n. Dy fotografi për dokument.

### Procedura e Pranimit

Drejtori i Shkollës Doktorale së bashku me Koordinatorët e Programeve shqyrtojnë dosjet e aplikantëve të depozituara pranë Zyrës së Informacionit dhe Dokumentacionit dhe përzgjedhin kandidatët në bazë të kriterëve përkatëse duke shqyrtuar dosjen e secilit aplikant. Kandidatët nga personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në institucionin e arsimit të lartë kanë përparësi.

Listat e kandidatëve fitues miratohen nga Këshilli i Profesorëve dhe shpallen nga Drejtori i Shkollës Doktorale jo më vonë se 2 javë nga mbyllja e aplikimeve.